

Alije Alimi, MA¹

UDC: 159.922:316.362.3

ROLI I FAMILJES NË ZHVILLIMIN E PERSONALITETIT TE FËMIJËT

**УЛОГАТА НА СЕМЕЈСТВОТО ВО РАЗВОЈОТ НА ЛИЧНОСТА КАЈ
ДЕЦАТА**

**THE ROLE OF THE FAMILY IN THE DEVELOPMENT OF
PERSONALITY IN CHILDREN**

Abstract

To know the human psychic life as a whole and to understand his personality, in addition to psychic phenomena and processes, we also must become familiar with the qualities of personality, with those characteristics (traits), which without human psychology, his activity and behavior cannot be explained. Through this paper, we will address the factors that influence the development of these personality qualities in children. Special attention will be paid to the role of the family, as one of the most important factors in the development of personality. It is not only the most suitable and at the same time the first social environment, where parents take care of the child, but there the child acquires the first habits, forms certain attitudes, creates human values and virtues. The child receives his first lessons in the family, in contact with his parents, he identifies with them.

Parents, in many ways, influence the personality of the child. They implement certain strategies in order to prepare children for successful confrontation with the challenges that await them. Some features of the parental educational style exert their influence in many areas of the school life of children and young people. The personality of children can change noticeably depending on the model of the parents' approach, the warmth they offer to the children, the styles of discipline they exercise and the security or insecurity they create for them.

¹ Fakulteti i Pedagogjisë “Shën Klimenti i Ohrit”, Universiteti “Shën Qirili dhe Metodi” - Shkup, Email: alije.alimi@gmail.com

A loving, supportive and safe environment is essential for a child's growth and development and for the formation of a strong personality. Positive experiences, such as support, good education and open communication help to build confidence and self-esteem, while negative experiences, such as failures or abuse, can negatively affect a child's development.

Keywords: *Personality, family, children, development, education*

Hyrje

Çdo njeri i rritur ka një histori personale të gjatë të jetës së tij, një të kaluar me plot ngjarje të këndshme, apo edhe banale, me ngjarje të kryera me vetëdije, apo edhe pa vetëdije. Çdo njeri është i ndryshëm nga të tjerët, ka një personalitet të veçantë, ka një strukturë psikike të dallueshme nga të tjerët, ka mënyrën e vet të mendimit dhe veprimit, ka tipare karakteristike që i takojnë vetëm atij.

Duke u nisur nga përvoja personale, si dhe profesionale e punës së përditshme me fëmijë, nxënës, studentë dhe të rritur, kam arritur të vërej individë me personalitete të ndryshme, dhe nga këtu më ka lindur ideja që të thellohem në hulumtimin dhe studimin e faktorëve të cilët ndikojnë në zhvillimin e personalitetit të individit. Në mënyrë të veçantë kujdes i kemi kushtuar familjes si faktor kyç në zhvillimin e personalitetit, duke u nisur nga ajo që fëmija kontaktin e parë me botën e jashtme e ka me prindin (me nënën menjëherë pas procesit të lindjes), e gjithë përvoja e tij pozitive, ngrohtësia, mbështetja, siguria, dashuria, si dhe përvojën negative, refuzimin, abuzimin, braktisjen, traumat e ndryshme, mund t'i marrë nga rrethi i tij familjar dhe të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e personalitetit të tij.

Në këtë punim do të trajtohen disa fenomene që kanë të bëjnë me familjen, prindërimin, stilet prindërore, si dhe qasja teorike e teoricienit Alfred Adler mbi këtë dukuri.

Qëllimi i këtij punimi ka të bëjë me atë se si të gjejmë forma dhe mënyra më lehtë të zbatueshme për prindërit dhe edukatorët për zhvillimin e një personaliteti sa më pozitiv tek fëmijët, si dhe vetëdijesimi i prindërve dhe familjarëve për rolin e rëndësishëm që kanë në raport me fëmijët e tyre.

Rëndësia e zhvillimit të personalitetit të fëmijëve

Personaliteti i njeriut është çështja themelore e psikologjisë bashkëkohore, kurse psikologjia e personalitetit vlerësohet sot nga shumë psikologë si disiplinë qendrore e sistemit të shkencave të psikologjisë, sepse vetëm me ndihmën e psikologjisë së personalitetit mund të kuptohet dhe të shpjegohet natyra e njeriut, zhvillimi i jetës psikike të tij, sikurse edhe zhvillimi i veprimtarisë dhe i sjelljes njerëzore.

Personaliteti është një koncept që përfshin tiparet e qëndrueshme të individëve, duke përfshirë mendimet, emocionet dhe sjelljet e tyre. Zhvillimi i personalitetit të fëmijëve është rezultat i një kombinimi të faktorëve biologjik, mjedisor dhe psikologjik. Një ndikim i tillë, i gërshetuar nga një sërë faktorësh, e bën unik personalitetin e një individi. (Murtezani, 2006).

Shumë psikologë e përcaktojnë personalitetin si një shembull unik të mendimeve, ndjenjave dhe sjelljes të një individi, që del në pah vazhdimisht gjatë kohës dhe nëpërmjet situatave. Në këtë përcaktim ka dy pjesë të rëndësishme. Nga njëra anë, personaliteti lidhet me dallimet unike - ato aspekte që e dallojnë një person nga çdonjëri tjetër. Nga ana tjetër, përcaktimi vë në dukje se personaliteti është relativisht i fortë dhe i qëndrueshëm, pikërisht për këtë arsye iu kushtohet rëndësi e veçantë faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit në periudhat e ndryshme të zhvillimit të individit. (Morris&Maisto, 2008).

Personaliteti mund të përkufizohet si një grup karakteristikash e tipare të organizuara të një personi. Shumë nga këto tipare e karakteristika kanë lidhje me gjenetikën e individit, pra zinxhirin gjenetik të prindërve dhe familjarët e gjerë ku përfshihen gjyshërit apo anëtarët e tjerë të familjes. Të gjithë këta përbëjnë ambientin familjar, mjedisin e parë social në të cilin ekspozohet fëmija dhe ku ai fillon të formohet si një individ i veçantë krahas gjenetikës dhe ambientit që e rrethon.

Zhvillimi i personalitetit është i lidhur ngushtë me zhvillimin emocional, moral dhe social të individit. Por ky proces është më gjithëpërfshirës dhe ngërthen aspektet fizike, kognitive dhe të sjelljes, që bashkërisht bëjnë që individi të jetë i veçantë nga të tjerët dhe njëherazi i ngjashëm me ta.

Familja si faktor i rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijët

Njeriu, si qenia më e përsosur nga të gjitha qeniet tjera të gjalla, ka një zhvillim të ndërlikuar të personalitetit të tij. Gjatë zhvillimit të personalitetit dallojmë mekanizmat e zhvillimit të njeriut dhe faktorët e formimit të tij. Mekanizmat e zhvillimit të njeriut janë: pjekuria organike dhe të mësuarit, ndërkaq faktorët e formimit të personalitetit janë: familja, moshatarët, shkolla, kultura, shoqatat, mjetet e informimit etj.

Shumë faktorë ndikojnë në ambientin familjar gjatë formimit të personalitetit të një fëmije, duke lënë gjurmë në karakteristikat sociale, psikologjike e morale, në personalitetin e tij, ndërtimin e një individi në shoqërinë e ardhshme. Faktorët më me ndikim në rritjen dhe mirëqenien e një fëmije janë të shumtë. Por, padyshim se një ndër ta si më i rëndësishmi është faktori prind dhe marrëdhënia në mes të dy prindërve.

Familja është njësia më e vogël shoqërore, ajo mund të përbëhet edhe nga vetëm dy persona të cilët kanë në mes tyre lidhje gjaku, besimi, kulture, jetojnë në të njëjtin mjedis dhe kujdesen për njëri tjetrin. Familja është mjedisi i parë i ballafaqimit, i kontaktit ose pikëtakimit të individit me botën. Ajo

mbetet institucioni i parë që ndikon në zhvillimin e personalitetit të fëmijës edhe pse gjatë rritjes e jetës shumë institucione të tjera kontribuojnë në zhvillimin e personalitetit. Ai në familje i merr njohuritë e para mbi shoqërinë dhe mëson normat bazë të sjelljes. Në familje, fëmijët mësojnë që nga aktivitetet bazike (të flasin, ecin, ushqehen, etj.), e deri tek proceset e mësimin të komunikimit me anëtarët, funksion ky që do t'i shërbejë fëmijës pasi të dalë nga ambienti familjar e të vendoset në kontakt me shoqërinë dhe institucionet tjera të saj.

Në familje fëmijët ndërtojnë mendimet e para dhe të kuptuarit, qasja fillestare mbi edukimin. Pra, familja si bashkësi është institucioni i parë biopsiko-social, në të cilin krijohet, zhvillohet, rritet dhe edukohet fëmija, mëson statuset dhe rolet, mëson si të sillet, si të komunikojë e ndërveprojë. Kjo e përgatit atë që më pas të ndërveprojë me botën jashtë. Që nga momenti që fëmija vjen në jetë, ai fillon të komunikojë (me veprime) deri në mësimin e të folurit, ai reagon e asociohet me dy prindërit apo anëtarët tjerë pjesëmarrës në procesin e rritjes dhe edukimit (gjyshërit, motrat, vëllezërit etj.). Ky lloj edukimi është esencial dhe determinues për personalitetin e tij të ardhshëm si individ i rritur. “Mungesa e dëshirës për të rritur fëmijët mund të jetë një ndër faktorët më kryesor që ndikojnë në këtë problematikë” (Guidubaldi, 1980).

Familja bërthamë ndërtohet mbi parimet e jetës bashkëshortore dhe fëmijëve, pra kjo nënkupton se fëmijët mund edhe të mos kenë të dy prindërit biologjik, por të jenë të mëmësuar apo të atësuar nga njëri apo tjetri prind; gjithashtu, familja e tillë mund të mos ketë asnjërin nga prindërit biologjik, por të jenë fëmijë të adoptuar e që kanë dy prindër në përkujdesje, rritje dhe edukim (Karaj, 2005).

Për çdo prind do të jetë më e lehtë të kuptojë, drejtojë, edukojë e udhëzojë një fëmijë kur parimisht njeh potencialet e tij nga baza gjenetike, e gjithashtu një nënë e cila mbart atë fëmijë për nëntë muaj në barkun e saj, domosdo që do ta njohë më mirë çdo reagim të fëmijës së saj, duke u mbështetur edhe në fazat që ka kaluar në periudhën e shtatzënisë. Konteksti i parë i zhvillimit të individit është mitra e nënës. Shkencëtarët po zbulojnë gjëra të reja rreth efekteve të këtij mjedisi të parë, ku përfshihen: roli i nivelit të stresit që kalon nëna shtatzënë, mënyra e ushqimit të saj, konsumimi i duhanit, konsumimi i alkoolit dhe drogave, ushtrimet e saj fizike dhe gjendja e saj e përgjithshme shëndetësore gjatë periudhës së shtatzënisë (Woolfolk, 2010).

Cilësia dhe fuqia e ndikimit edukativ të familjes varet nga shkalla e formësimit të familjes, respektivisht, nga ajo se sa është familja “veprues i qëllimshëm dhe i organizuar edukativ” (Samilaniq & Toliçiç, 1976). Njëkohësisht, efekti edukativ i familjes kushtëzohet në një anë, nga harmonizimi i qëllimeve dhe veprimeve edukative të familjes me faktorët e tjerë edukativë, dhe në anën tjetër, nga shkalla e koordinimit dhe veprimeve edukative të faktorëve të tjerë edukativë me familjen (Shaffer, 1979).

Kur flitet për tipat e familjes, përmenden disa lloje, mirëpo ne do të ndalemi në familjet funksionale dhe familjet jofunksionale.

Modelet funksionale të familjes konsiderohen se mundësojnë arritjen e qëllimeve familjare, ofrojnë dhe mundësojnë kushte të volitshme për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijëve si në aspektin fizik, duke përfshirë edhe zhvillimin paranatal, zhvillimin gjuhësor, emocional, social, moral, përfshirë edhe zhvillimin e personalitetit të tyre.

Përvoja që kalon një fëmijë me familjen ka ndikim të madh në formimin e personalitetit të tij dhe ndihmon në zhvillimin e karakterit dhe sjelljeve të tij. Përjetimet pozitive, si suksesi, lavdërimi dhe mbështetja, kanë një efekt të rëndësishëm në rritjen e vetëbesimit, ndihmojnë fëmijën të zhvillojë aftësi sociale dhe i japin mundësinë të krijojë një vetëvlerësim të shëndetshëm. Kur një fëmijë merr mbështetje, ai zhvillon ndjenja të sigurisë dhe mund të ndërtojë marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët.

Familjet jofunksionale përkufizohen ndryshe edhe si familje në të cilën ka konflikt, sjellje të papërshtatshme dhe abuzime të anëtarëve individual të familjes, ndërsa pjesa tjetër e shtëpisë detyrohet të përshtatet me veprime të tilla (Stoop&Masteller, 1997)

Përvojat negative mund të lënë gjurmë të thella në personalitetin e fëmijës. Fëmijët që përjetojnë humbje, dështime ose shpërfillje mund të ndihen të pasigurt dhe të zhvillojnë ndjenja frike, ankthi dhe tërheqjeje nga jeta sociale. Ky ndikim mund të shfaqet në mënyrën se si ata ndërveprojnë me të tjerët, si dhe në mënyrën se si ata e perceptojnë veten dhe botën përreth. Dështimet e përsëritura ose humbjet e mëdha mund të çojnë në formimin e një ndjenje të pafuqisë dhe mund të ndikojnë në zhvillimin e vetëbesimit të fëmijës. Traumat mund të jenë të ndryshme, nga humbja e një prindi ose ndarja e familjes, deri tek përvoja të tjera të dhimbshme si abuzimi, ngacmimi ose neglizhenca. Pasojat e këtyre ngjarjeve mund të shfaqen si pasiguri emocionale dhe sjellje të mbyllura. Traumat që ndodhin në fëmijëri kanë potencialin të ndikojnë në zhvillimin e personalitetit gjatë gjithë jetës, prandaj është thelbësore që fëmijët të kenë mbështetje emocionale dhe profesionale për të përballuar dhe tejkaluar këto përvoja.

Forma të ndryshme të abuzimeve që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve

Studimet në mënyrë të vazhdueshme kanë vërtetuar se afërsia joadekuatë që ndjen fëmija ndaj atyre që përkujdesen, mund të pengojë në mënyrë të theksuar zhvillimin social dhe emocional përgjatë gjithë jetës. Mënyra sesi plotësohen nevojat dhe kërkesat themelore në foshnjëri, por edhe në fazat e mëvonshme, mund të lënë gjurmë në personalitetin e individit, andaj shumë psikologë besojnë se përvoja e fëmijës në familje është parësore për zhvillimin e personalitetit.

Duke u mbështetur në përvojën personale në punën me fëmijë, si forma më të shpeshta të abuzimeve që iu bëhen fëmijëve nga ana e prindërve ose kujdestarit, mund të themi që janë:

Abuzimi fizik - përfshin veprime të paramenduara të dhunës që rrezikojnë jetën e fëmijës, të lëndohet ose të vritet. Simptoma të tillë si gërvishtje, eshtra të thyer, shenja të djegies, mund të jenë shenja të abuzimit fizik. Njëherazi, prindërit ose kujdestarët abuzues kundërshtojnë të furnizojnë fëmijën me ushqim dhe veshmbathje, strehim dhe përkujdesje mjekësore.

Abuzimi seksual - është një keqpërdorim i fëmijës, gjatë të cilit të rriturit i shfrytëzojnë për kënaqësi seksuale dhe ekspozimin e tyre në veprime të dhunshme seksuale. Në të shumtë e rasteve fëmijët që përjetojnë abuzim seksual, zgjedhin të heshtin për shkak të ndjenjës së turpërimit dhe fajit që paraqitet tek ata. Fëmijët e këtillë gjatë periudhave të zhvillimit të tyre përjetojnë stres, ankth, trauma të ndryshme, situata këto që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e personalitetit të tyre.

Abuzimi emocional - trondit ndjenjën e vetëbesimit të fëmija. Raste të tilla kemi kur të rriturit vazhdimisht kërcënojnë fëmijën me fjalë, me të shara, kritika të vazhdueshme të nënçmimit etj. (Murtezani, 2006)

Karakteristikë e këtyre akteve të palejuara verbale apo joverbale është synimi të cenohet personaliteti i fëmijës, të thyhet morali dhe t'i shkatërrohet vetëbesimi. Një fëmijë që përjeton qoftë edhe vetëm një element të ndonjë forme të abuzimit, pasojat do t'i vuajë gjatë zhvillimit të personalitetit të tij.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që prindërit, mësuesit dhe profesionistët e shëndetit mendor të jenë të vetëdijshëm për ndikimin që mund të kenë përvojat e fëmijëve në formimin e personalitetit të tyre. Një mbështetje e duhur dhe një mjedis pozitiv mund të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi të shëndetshme për të menaxhuar ndjenjat dhe për të ndërtuar një personalitet të fortë dhe të ekuilibruar.

Lidhja midis prindërimit dhe zhvillimit të personalitetit të fëmijës

Prindërimi është një shqetësim i vazhdueshëm dhe madje shumë kompleks në shoqërinë e sotme. Fillimisht, pasiguria për të qenë prind, heqja dorë nga "liria" individuale, kujdesi vetëm për veten, përgjegjësia dhe përkushtimi ndaj një fryti që vetë e sjellin në jetë, përfshi këtu edhe dinamikën në të cilën jetojmë, janë vetëm disa nga elementet dhe vështirësitë që e presin një nënë dhe baba. Mirëpo të gjitha këto nuk e lënë të zbehet dëshira dhe dashuria për të pasur fëmijë. Por, sigurisht se nuk mjafton vetëm dëshira dhe dashuria për ta rritur një fëmijë. Me vetë fëmijën edhe prindi rifillon edukimin e tij dhe sfidën e kënaqshme për atë që pret nga vetja dhe fëmija. Shkalla e edukimit, formësimi i prindërve luan rol shumë të rëndësishëm. Kur prindërit njohin pozicionin e tyre karshi fëmijës, paracaktojnë qëllime të përbashkëta për edukimin e tij dhe njëkohësisht respektojnë potencialet e natyrës së fëmijës,

sigurisht se ata po ndihmojnë në formimin e një individi të shëndoshë, të mirëqenë për shoqërinë e së ardhmes.

Kësaj çështje, pra rolit të prindërve, një mbështetje të madhe në shkrimet e tij i jep edhe mjeku, psikanalisti, psikiatri, profesori i psikanalizës, Dr. Nikos Sideris, i cili e krahason atë me gjërat më elementare për ekzistencën e qenies njerëzore, ushqimin dhe ujin, ku ndër të tjera thotë: Në çdo rast, në formimin e një fëmije, ekzistenca e prindërve në vendin dhe rolin e tyre, që funksionojnë në më të mirën e mundshme, siç e kërkon cilësia e prindit, është po aq e nevojshme sa ushqimi dhe uji. Dhe këtë fëmijët e dinë mirë (Sideris, 2010). Pra, fëmijët kanë nevojë të pazëvendësueshme për prindërit e tyre.

Në hulumtimet dhe studimet e sotme ka mendime, shkrime, publikime të shumta për martesat, familjet dhe stilet e prindërimit. Pavarësisht se kush është përgjegjës për rritjen e fëmijës, studimet kanë treguar se ekzistojnë dallime thelbësore në stilet e prindërimit (Woolfolk, 2010). Një nga studiuesit e shumtë të kësaj fushe është edhe Diane Baumrindi, e cila gjatë viteve 1991-1996 bëri kërkimet më të njohura deri më sot për stilet e prindërimit, të cilat kryesisht ishin të përqendruara në studimin e saj gjatësor të 100 fëmijëve parashkollorë, shumica prej të cilëve i takonin shtresës së mesme euro-amerikanë.

Baumrindi theksoi 4 stile të prindërimit: prindërit me autoritet, prindërit autoritar, prindërit tolerant dhe prindërit refuzues.

Prindërit me autoritet - (shumë dashuri, shumë kontroll) përcaktojnë qartazi kufijtë dhe presin që fëmijët e tyre të sillen si të pjekur (Woolfolk, 2010). Këta prindër, me dashurinë që kanë, shprehin edhe ngrohtësi me fëmijët e tyre, dëgjojnë shqetësimet e tyre, vendosin rregulla për të cilat edhe japin shpjegime dhe vendosin në mënyrë demokratike për zbatimin e tyre. Në këtë stil prindërimi ka më shumë orientim e udhëzim dhe fare pak ndëshkim e sidomos ndëshkime të rrepta. Prindërit i ndihmojnë dhe këshillojnë fëmijët që të mund t'i parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre dhe kështu hapësira për ndëshkim nga ana e tyre mbetet e paktë. Me një bisedë, në atë masë që qëndrimi i prindërve ofron dashuri dhe rregulla, fëmija do të formohet dhe do të jetojë me dashuri dhe me ekuilibër. Nëse nuk respektohet ky parim i lartë - dashuri dhe rregull, atëherë fillojnë të ndodhin shtrembërime, përplasje, prishje të ekuilibrave si dhe debate me fjalë të shumta dhe boshe, që as e ndriçojnë dhe as e ekuilibrojnë situatën (Sideris, 2010).

Prindërit autoritarë (pak dashuri, shumë kontroll) - paraqiten të ftohë të dhe kontrollues në ndërveprimet e tyre me fëmijët (Sideris, 2010). Prindërit autoritarë vendosin rregulla për të cilat nuk japin shpjegim te fëmijët e tyre, këta presin zbatim dhe nëse u kërkohet shpjegim nga ana e fëmijëve, përdorin thjesht autoritetin dhe përgjigja e vetme është “sepse unë thashë kështu”. Nëse nuk respektohet rregulli ose fjala, rezulton me dënime të ashpra. “Sipas Baumrind, këta prindër janë të bindur dhe të orientuar drejt statusit dhe presin

që urdhrat e tyre të zbatohen pa sqarim” (Cherry, 2011). E gjithë kjo nuk nënkupton se mungon dashuria ndaj fëmijëve të tyre, edhe pse nuk flitet për emocion në këtë lloj stil prindërimi, por ata thjesht nuk e shprehin dashurinë ndaj fëmijëve të tyre.

Prindërit tolerantë - (shumë dashuri, pak kontroll). Prindërit e tillë janë të mendimit se fëmijët nuk do të duhej të kenë shumë rregulla apo të kërkohej që të sillen si të pjekur, fëmijët thjesht janë fëmijë (Cherry, 2011). Mirëpo, a është mënyra e duhur kjo karshi fëmijëve? Rezultatet kanë treguar se fëmijët me prindër të tillë në të ardhmen kanë prirje të jenë impulsiv, me shfaqje agresiviteti, pa qëllime të caktuara në jetë dhe kanë aftësi të ulët vetë-kontrolli. Psikanalisti Nikos Sideris (2010), mbështet mendimin se një prindërim i tillë nuk është për tu lavdëruar. Ai thekson se “në një shtëpi të gjithë janë të barabartë sa i takon dinjitetit të tyre, por njëkohësisht janë asimetrik sa u takon vetive, cilësive të tyre”. Sipas tij, është absurditet që të vegjël dhe të mëdhenj të mendojnë se çdonjëri është kapiteni brenda shtëpisë. Kur në një shtëpi nuk ka rregulla, atëherë të gjitha degradojnë. Prandaj, toleranca e tepërt dhe mungesa e rregullit dhe disiplinës nga prindërit mund ta llastojë fëmijën deri në atë masë sa prindi duhet të bëjë çdo gjë që fëmija i tij kërkon. Në të ardhmen kjo jep rezultate jo të mira për jetën e tij, pavarësisht se këta prindër janë të ngrohtë e të kujdesshëm (Sideris, 2010).

Prindërit refuzues - (pak dashuri, pak kontroll), këta prindër duket sikur nuk kanë interes për komunikimin, bashkëpunimin apo mësimin e fëmijëve të tyre.

Studimet e deritanishme tregojnë se: deri tani prindërimi i stilit autoritar, orientues dhe i kombinuar me ngrohtësi e mbështetje emocionale ka dhënë rezultatet më të mira në rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët të cilët janë rritur në praninë e prindërve të tillë dinë si të kenë prioritetet, rregulla dhe synime të cilat do t’i arrijnë në jetën e tyre (Sideris, 2010).

Ndikimi i familjes në formimin e personalitetit të fëmijës është një fushë studimi mjaft e gjerë, shumë interesante dhe tejet sfiduese. Hulumtime të shumta, studime, artikuj dhe literatura në fushat e edukimit, psikologjisë, sociologjisë, kryesisht pra shkenca që studiojnë shoqërinë, teori të shumta që flasin për sjelljen dhe personalitetin e individin, japin përgjigje nga më të ndryshmet në lidhje me këtë temë.

Sa herë që ndërhyjmë te fëmijët, duhet të kemi për qëllim t’i ndihmojmë të mësojnë se si duhet të sillen dhe t’u shërbejmë mirë si të rritur. Ne të gjithë kemi mendime herë pas here se çfarë do të thotë të jesh prind (Sandahl & Alexander, 2016). Deri tani asnjëherë nuk është mohuar se disiplina pozitive, autoriteti prindëror pozitiv dhe përgjegjësia e familjes në detyrat që ka për fëmijën, kanë dhënë rezultatet më të mira në të arriturat e fëmijës, pavarësisht se në cilën fazë të rritjes është ai. Fëmija nuk merr edukim vetëm në veprime

konkrete dhe momente të caktuara apo faza të rritjes, ku prindërit ndikojnë qëllimshëm dhe në formë direkte, por ata edukohen në çdo moment dhe sjellje që ju prezantohet me apo pa dashje në ambientin ku rriten. E rëndësishme nuk është vetëm që t'u flasim fëmijëve, por që të flasim me ta dhe më e mira nga të gjitha ndoshta është që prindërit të flasin më pak dhe të dëgjojnë më shumë, sipas një hulumtimi nga Rachel Romeo (2018).

Diçka shumë e rëndësishme që duhet theksuar, është se si prindërit përcjellin introjektet te fëmijët e tyre. Introjeksiioni ndodh kur një person përvetëson idetë ose zërat e njerëzve të tjerë - shpesh autoritete të jashtme (prindërit). Një shembull i introjektimit mund të jetë një baba që i thotë djalit të tij “djemtë nuk qajnë” - kjo është një ide që një person mund ta marrë nga mjedisi i tij dhe ta përvetësojë në mënyrën e tij të menduarit. Fëmija nuk po identifikohet domosdoshmërisht me personin që e ka thënë këtë (babain e tij), por ai e merr atë dhe bëhet pjesë e mënyrës se si e sheh botën (dhe rrjedhimisht, se si ata besojnë se duhet të sillen). Me kalimin e kohës, kjo mund të çojë në identifikimin me individin që ia ka thënë atë. Kjo do të dukej sikur djali do të ndiqte hapat e babait të tij, dhe do të bëhej si babai i tij, në më shumë mënyra sesa thjesht një besim. Ata mund të ndjekin një rrugë të ngjashme karriere, të vishen në mënyrë të ngjashme dhe të marrin sisteme të tjera besimi të ngjashme. Kështu, jo vetëm që po marrin besimin e vetëm se “djemtë nuk qajnë”, por gjithashtu fillojnë të identifikohen me personin që e tha atë.

Sipas geshtalt psikoterapistëve, ajo që vjen nga rrethi (familja) duhet të tretet dhe të përvetësohet, nëse duam që ajo të bëhet vërtet e jona, pjesë e personalitetit tonë. Por nëse ndodh, që të pranoni në mënyrë jokritike, sepse dikush thotë se duhet, ose sepse është në modë, ose sepse është diçka tradicionale, e sigurt, e vjetëruar, e rrezikshme - atëherë kjo është ajo që na vjen si një gur në stomak, si diçka vërtet e patretshme. Do të vazhdojë të jetë e huaj për trupin, megjithëse mund të jetë pjesë e mendjes sonë. Kështu, qëndrimet e patretura, mënyrat e veprimit, ndjenjat dhe vlerësimet, në psikologji emërtohen si introjekte. (Polster&Polster, 1974).

Introjektet zhvillohen kryesisht gjatë fëmijërisë dhe bëhen pjesë e personalitetit të çdo individi, derisa individi të arrijë në një vetëdijesim për t'i përpunuar ato, për t'i përvetësuar ose refuzuar. Andaj, secili prind duhet të jetë i vetëdijshëm për mënyrën se si i qaset fëmijëve të tij dhe se çka u përcjell atyre.

Qasjet teorike mbi zhvillimin e personalitetit te fëmijët

Teoritë për formimin e personalitetit ndihmojnë në kuptimin e mënyrës se si individët zhvillohen dhe si ndihen në marrëdhëniet sociale. Psikologjia e personalitetit është një fushë e larmishme me teori të shumta, të cilat përpiqen të shpjegojnë dhe kuptojnë personalitetin njerëzor.

Rëndësia e teorive të personalitetit është se na ndihmojnë të njohim më mirë zhvillimin individual të fëmijëve, nxënësve, adoleshentëve dhe të

rriturve. Duke pasur parasysh njohuritë që na i ofrojnë teoritë e ndryshme të personalitetit, do të jemi shumë më pak konfuz dhe të pasigurt për sa i përket zhvillimit të personalitetit të fëmijëve.

Teoria e Alfred Adler (1870-1937)

Adlerit i takon merita si teoricien i parë që trajtoi ndikimin të fëmija jo vetëm të prindërve dhe të rriturve të tjerë, por edhe të motrave dhe vëllezërve gjithashtu. Konsiderata e tij për ndikimin e vëllezërve dhe motrave dhe radha në të cilën ata kanë lindur, është me sa duket ajo që Adleri është nga më të njohurit. Adleri e konsideronte rregullin e lindjes si një tjetër ide të dobishme që kontribuon në njohjen e personalitetit të individëve.

Fëmija i vetëm - ka mundësi më shumë se të tjerët të llastohet, prindërit e fëmijës së vetëm ka më shumë të ngjarë të kenë kujdes të veçantë, nganjëherë kujdes të mbushur me shqetësim të tepruar, për krenarinë dhe gëzimin e tyre. Nëse prindërit janë abuziv, nga ana tjetër, fëmija i vetëm do të duhet ta durojë këtë abuzim i vetëm.

Fëmija i parë - fillon jetën si një fëmijë i vetëm, me gjithë përkujdesjen ndaj tij. Por, sapo gjërat bëhen të rehatshme, arrin fëmija i dytë dhe e “rrëzon nga froni”.

Fëmija i dytë - është në një situatë krejt të ndryshme: ai ka fëmijën e parë si një lloj “lideri” dhe përpiqet të bëhet tërësisht konkurrues, vazhdimisht përpiqet të kalojë fëmijën më të rritur.

Fëmija i sapolindur - ka të ngjarë të jetë shumë i përkëdhelur në familjen me më tepër se një fëmijë. Megjithatë, është i vetëmi që nuk rrëzohet kurrë nga froni. (Boeree, 2004).

Sipas teorisë së Adlerit, në zhvillimin e personalitetit të fëmijës ndikon edhe shtrirja kohore midis lindjes së fëmijëve. Nëse ka një shtrirje kohore të gjatë midis fëmijëve, ata mund të mos e shohin veten dhe njëri-tjetrin në të njëjtën mënyrë sikur të ishin më afër me vite së bashku. Dhe nëse disa nga fëmijët janë vajza e disa djem, kjo përbën një dallim gjithashtu.

Një nga termët e hershëm të Adlerit ishte “protesta mashkullore”. Ai vuri re diçka të dukshme në kulturën e tij (si fenomen i pranishëm edhe në vendin tonë), se djemtë vlerësoheshin më shumë se sa vajzat. Djemtë donin, shpesh me këmbëngulje, të tregoheshin si të fuqishëm, agresivë, “mashkullor” dhe jo të dobët, pasivë ose të varur, me fjalë të tjera, “femërorë”. Sipas tyre, ata mbi të gjitha kanë forcën, arsimimin dhe me sa duket talentin dhe motivimin e duhur për të bërë “gjëra të mëdha”, ndërsa vajzat jo. Nëse një djalosh nervozohet ose kërkon të veprojë sipas mënyrës së tij (protesta mashkullore), ata do të thonë se ai është një djalë normal, ndërsa nëse një vajzë e vogël është e qetë dhe e ndrojtur, ajo vlerësohet për feminitetin e saj. Nëse, nga ana tjetër, djali është i qetë dhe i ndrojtur, ata shqetësohen se ai mund të rritet duke qenë

si i squllur, ose nëse vajza është e sigurt dhe ndjek rrugën e saj, ata e quajnë atë “mashkull” dhe do të përpiqen t’ju bindin për të hequr dorë nga këto. (Boeree, 2004).

Fëmijëria sipas teorisë së Adlerit

Adleri e pa personalitetin ose stilin e jetës si diçka të ngulitur mjaft herët në jetë. Ai mendon se ka tre situata fëmijërore bazë, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve.

- E para është **inferioriteti i organeve**, si edhe sëmundjet e hershme të fëmijërisë. Ato ai i quante “të mbingarkuara” dhe nëse dikush nuk kishte sukses të tërhiqte vëmendjen e tyre te të tjerët, ata do të mbeteshin të fokusuar te vetja.

- E dyta është **përkëdhelja**. Shumë fëmijë mësohen nga veprimet e të tjerëve se mund të marrin pa dhënë. Dëshirat e tyre te kushdo tjetër janë urdhëra.

- E treta është **braktisja**. Fëmija që është lënë pas dore ose abuzuar, mëson po atë që mëson dhe fëmija i llastuar, por në një mënyrë të drejt-përdrejtë. Ata mësojnë inferioritetin, sepse u thuhet dhe u tregohet çdo ditë se janë të pavlerë.

Konceptet që përfshihen në teorinë e Adlerit, si radha e lindjes së fëmijëve, “protesta mashkullore”, fëmijëria, si dhe stili i jetës, vërehen edhe në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, të kulturës dhe traditës sonë.

Conclusion

Personality is a concept that includes the stable traits of individuals, including their thoughts, emotions and behaviors. The development of children’s personality is the result of a combination of biological, environmental and psychological factors. Such an influence, intertwined with a number of factors, makes an individual’s personality unique.

The most influential factors in the growth and well-being of a child are numerous. But, undoubtedly, one of the most important of them is the parent factor and the relationship between the two parents. In the family, children build their first thoughts and understanding, the initial approach to education. So the family as a community is the first bio-psycho-social institution in which the child is created, develops, grows and is educated, learns statuses, roles, learns how to behave, communicate and interact. This prepares him to then interact with the outside world.

In today’s research and studies, there are numerous opinions, writings, and publications about marriages, families, and parenting styles. “Regardless of who is responsible for raising a child, studies have shown that there are fundamental differences in parenting styles”.

The importance of personality theories is that they help us to better understand the individual development of children, students, adolescents, and adults. Considering the knowledge that different personality theories offer us,

we will be much less confused and uncertain about the development of children's personalities.

Alfred Adler is the first theorist to address the influence on the child not only of parents and other adults, but also of siblings. His consideration of the influence of siblings and the order in which they are born is probably what Adler is best known for. Adler considered birth order to be another useful idea that contributes to the understanding of the personality of individuals. Adler, by offering in his theory concepts such as: lifestyle, childhood, "masculine protest" and birth order, has enabled us to understand through these concepts the influence of the family circle on the development of the child's personality.

A loving, supportive and safe environment is essential for a child's growth and development and for the formation of a strong personality. Positive experiences, such as support, good education and open communication help to build confidence and self-esteem, while negative experiences, such as failures or abuse, can negatively affect a child's development. Therefore, it is essential that everyone who is part of a child's life contributes to helping and supporting them to ensure a healthy and successful growth.

In this context, it is important for parents, teachers and mental health professionals to be aware of the impact that children's experiences can have on the formation of their personality. Proper support and a positive environment can help children develop healthy skills to manage feelings and build a strong and balanced personality.

Literatura:

1. Boeree, G. (2004). *Teoritë e personalitetit*, Tiranë, Plejad
2. Cherry, K. (2011). *Parenting Styles. The four style of parenting*
3. Guidubaldi, J. (1980). *The status report extended: Further elaborations on the American family*. School Psychology Review, 9 (4), 374-379.
4. Kaliqi, F. (2006). *Child's psychological development and family education*, Skopje, Logos
5. Karaj, Th. (2005). *Zhvillimi psikik i fëmijës*, Tirana, Progres
6. Murtezani, L. (2006). *Psikologjia e zhvillimit*, Tetovo, Cabej.
7. Musai, B. (1999). *Psikologjia e edukimit*, Tirana, Pegi.
8. Morris, Ch. & Maisto, A. (2008). *Psikologjia shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore*, Tirana, CDE
9. Samilaniq, V., & Toliçiç, I. (1976). *Psikologjia Fëmijënore*. Prishtinë: Riliindja.
10. Sandahl, I., & Alexander, J. (2016). *The Danish Way of parenting*. New York: Teacher Perigee.
11. Shaffer, D. (1979). *Social and personality development*. London: Cengage Learning.

12. Sideris, N. (2010). *Fëmijët nuk duan psikolog. Duan prindër!* Tiranë: Nereid
13. Stoop, D. & Masteller, J. (1997). *Forgiving Our Parents, Forgiving Ourselves: Healing Adult Children of Dysfunctional Families.* Gospel Light. ISBN: 0830734236, 9780830734238
14. Polster E. & Polster, M. (1974). *Gestalt Therapy Integrated*, New York: Vintage
15. Ulvan, A, N. (2008). *Edukimi i fëmijëve në islam.* Cyrih, Fondacioni i Rinisë Islame
16. Woolfolk, A. (2010). *Educational Psychology.* Tiranë: Centre Democatic Education (CDE).